




**KOMUNA -OPŠTINA
KLOKOT - VËRBOVC
KLOKOT - VRBOVAC**



PLANI I VEPRIMIT PËR PËRMIRËSIMIN E SHËRBIMEVE

SHËRBIMET: GRUMBULLIMI DHE DEPONIMI I MBETURINAVE

VITI : 2011

GRUPI PUNUES:

1. Refik Halili, zëvendëskryetar dhe koordinator i grupit punues
2. Boban Bogdanović, zyrtar për shërbime publike komunale
3. Dragisa Kojić, zyrtar i punëve të kuvendit
4. Miroslav Stolić, zyrtar për projekte dhe zhvillim ekonomik
5. Zoran Denić, sipërmarrës privat „Aqua Koki“ - Klokot
6. Nikola Stolić, drejtor i OJQ-së „Radio-Klokot“ në Klokot.

ANALIZA E SITUATËS

Karakteristikat e përgjithshme të komunës Klokot-Vërbovc

Komuna e Klokot-Vërbovcit ndodhet në km e 50 në juglindje të Prishtinës dhe është themeluar në vitin 2009. në përputhje me Planin mbi decentralizimin e cila është implementuar në Kosovë në përputhje me propozimin Gjithpërfshirës për Zgjidhjen e Statusit të Kosovës(Marti Ahtisari).Seanca e parë konstitutive e Kuvendit komunal të sapothemeluar është mbajtur më 8 janar të vitit 2010. Kjo komunë e sapothemeluar mbulon një sipërfaqe prej 23.8 km² dhe brenda saj janë të përfshira katër fshatra,dhe ato: Klloko/Klokot, Mogillë/Mogjia, Vërbovc/Vrbovc dhe Gërçarë /Grnçar. Është vlerësuar se në territorin e kësaj komune banojnë

përafërsisht 5.050 banorë, gjegjësisht 700-800 familje në mes tyre 3.710 Sërb dhe 1.340 Shqiptar. Fshatrat e përziera që janë pjesë e komunës Kllokot-Vërbovcit janë Mogilla/Mogila dhe Kllokoti/Klokot, ndërsa fshatrat në të cilat jetojnë ekskluzivisht sërëbët e Kosovës janë Vërbovc/Vrbovac dhe Gërncari/Grnçar.

Komuna e Kllokot-Vërbovcit është e njohur me pishina natyrore të ujërave minerale dhe shëruese, fontanave termale po ashtu edhe me fashrikën e cila prodhon ujën mineral „Kllokoti”. Për rreth këtyre pasurive specifike ku vec ka filluar me investime, Kllokot-Vërbovc ka shumë mundësi të shfrytëzimit pasurisë e saja të bukura natyrore. Si për shembull, malet e Sharrit mund të shikohen në horizont, lumi Morava e Bincës që kalon nëpër qytet dhe Kllokoti është vecanarisht i pasuruar me ujë e cila është testuar dhe vlerësuar si ujë shërues medicinal. Kllokot-Vërbovc po ashtu ka klimë kontinentale e cila si rezultat ka relativisht dimër të shkurtër dhe verë të gjatë. Përvec kësaj, në territorin e kësaj komune gjendet edhe vendi i rëndësishëm arkeologjik, ku zbulon skulpturën e femrës ilire me kostume të vecanta. Popullsia e kësaj komune të vogël rurale kryesisht merren me bujqësi, d.m.th, kultivimin e drithërave, frutave dhe perimeve.

Në përputhje me prioritetet e përcaktuara dhe kompetencat e tij, kryetari Sasa Mirkovic së bashku me bashkëpunëtorët e tij në shkurt të vitit 2011 në nivelin komunal ka formuar Grupin Punues për punimin e planit të veprimit për përmirësimin e shërbimeve dhe deponimitin e mbeturinave (më poshtë: Grupi punues). Grupi punues i komunës së Kllokot-Vërbovcit ka për qëllim që përmes këtij plan veprimi :

1. paragesin një analizë të detajuar të gjendjes aktuale në lidhje me menaxhimin e mbeturinave
2. të tregojnë për problemet aktuale,
3. përcakton prioritetet dhe qëllimet, të cilat komuna dëshiron ti arrijë në të ardhmën dhe,
4. aktualisht mënyrën e arritjes së qëllimeve të tyre prioritare, d.m.th mënyrat për përmirësimin e grumbullimit dhe deponimit të mbeturinave në komunën e Kllokot-Vërbovcit.

Përvec të lartpërmendurave, Plani i veprimit është një udhëzues për komunën e Kllokot-Vërbovcit në lidhje me përmirësimin e shërbimeve të grumbullimit dhe deponimit të mbeturinave, largimin e deponive ilegale dhe për të parandaluar më tej ndikimin e tyre negativ mbi banorët e komunës dhe zonave për rreth, të cilat do të kontribuojnë në mbrojtjen e përhershme të mjedisit.

GRUMBULLIMI DHE DEPONIMI I MBETURINAVE NË KOMUNËS E KLLOKOT-VËRBOVCIT

Me Ligjin për Vetëqeverisjen lokale është paraparë ofrimi i shërbimeve publike, grumbullimi dhe deponimi i mbeturinave dhe mbrojtjen e mjedisit jetësor paragesin burimet e përgjegjësisve komunale. Komuna e Kllokot-Vërbovcit në aspektin e grumbullimit dhe deponimit të mbeturinave në vitin 2010, ka nënshkruar një marrëveshje të përkohëshme me kompaninë Regionale të shërbimeve publike (më poshtë: KRSHP), „Higjiena” nga Gjilani mbi ofrimin e këtyre shërbimeve në territorin atëkohë komunës së

samothemeluar Kllokot-Vërbovc. Komuna ka planifikuar të formoj kompaninë e shërbimeve publike e cila do të ofronte këtë shërbim dhe në lidhje me këtë nga USAID-i nga ky program iniciativa për efikasitetin e komunës (EMI) në vitin 2010 ka marrur një kamion të vogël me kapacitet 2,5 ton për grumbullimin e mbeturinave dhe 100 kontenjera metalik voluminoz 1,1 m³. Me marrëveshtjen nga viti 2010 ka qenë e parapë që programi USAID-i EMI

mbulojë shpenzimet operative, e që Komuna graduallisht të marrë përgjegjësitë që nga buxheti i tij të paguajë shërbimet e grumbullimit dhe deponimit të mbeturinave KRSHP „Higjiëna" nga Gjilani. Komuna obligimet e saj nga marrëveshtja me KRSHP „Higjiëna" i ka plotësuar.

Megjithatë, me kohë është vërtetuar që aso programi (marrëveshtje) nuk është i qëndrueshëm dhe se komuna nga buxheti i saj nuk ka mundësi ti kryej të gjitha shpenzimet për ofrimin e këtyre shërbimeve. Prandaj është në bashkëpunim me USAID-in me programin e ri iniciativa demokratike dhe efektive e komunale (DEMI) dhe KRSHP „Higjiëna" nga Gjilani, më 15 mars të vitit 2011. është nënshkruar një marrëveshtje e re shume e favorshme, me të cilën KRSHP „Higjiëna" do të vazhdojnë të ofrojë shërbime, ndërsa USAID programi DEMI do të mbulojë shpenzimet operative për tre muajt e parë deri sa pagesat e shërbimeve nga banorët dhe subjektet afariste deri sa mos të ringjallet komuna.

Marrëveshtja nga marsi i vitit 2011 është implementuar me sukses. Pesë punëtorët cdodite shfrytëzojnë kamionin e komunës dhe një mori kontenjerësh dhe i ofrojnë shërbim qytetarëve të komunës Kllokot-Vërbovc.

Burimet e disponueshme dhe avantazhet

Grupi punues me situatën analizuese ka vërtetuar se përfitimet dhe resurset aktuale të cilat komuna Kllokot-Vërbovc i ka këto:

1. Angazhimi i udhëheqësve komunal që pozitivisht të zhgjidhin këtë qështje të ngushtë dhe në përputhje me këtë është formuar Grupi punues i cili detailsht merrret me këto probleme,
2. Gjashtë punëtorët komunal,
3. Zyrtari për shërbime publike dhe komunale e cila duhet të ketë parasysh grumbullimin adekuat të mbeturinave,
4. Kamioni për grumbullimin e mbeturinave marka ISUZU, me kapacitet 2.5 ton,
5. 150 kontenjera me vëllim 1.1 m³ (100 kontenjiera janë marrur nga USAID programi EMI në vitin 2010, ndërsa 50 nga USAID programi DEMI në prill të vitit 2011),
6. Kompjuter, printer dhe programin KRSHP „Higjiëna" për dhënjen e fakturës të cilën zyrtari ikuvendit komunal do ta shfrytëzoj për printim dhe dhënje të fakturës,

7. Broshurat të cilat kanë për qëllim ngritjen e vetëdijësimit të qytetarëve për pagesat e shërbimeve të grumbullimit dhe deponimit të mbeturinave, si dhe mbrojtjen e ambientit jetësor,
8. Përfaqesuesit e fshatrave janë të gatshëm ti përkrahin të gjitha aktivitetet të cilat mundësojnë që shërbimet të ngriten në nivel më të lartë.

Disavantazhet dhe rreziqet e mundëshme

Grupi punues i komunës për përgaditjen e planit të veprimit për përmirësimin e shërbimeve të ngrumbullimit dhe deponimit të mbeturinave me analizat e saj ka identifikuar mangësi dhe rreziqe të menaxhimit të mbeturinave:

1. Ekzistimi i të ashtuquajturave deponi të egra të cilat qytetarët i shfrytëzojnë për grumbullim të mbeturinave,
2. Mungesa e mjeteve në buxhetin e komunës e cila do të ishte e ndarë për shërbimet komunale,
3. Mungesa e hapësirës adekuate të punës për pjunëtorët e shërbimeve ekzistuese,
4. Mungesa e një Departamenti të vecantë komunal me një numër të mjaftueshëm të punëtorëve të cilët do të merren ekskluzivisht me këtë dhe çështje të ngjashme në bazë të Ligjit mbi Vetëqeverisjen Lohale në kompetencat e komunës dhe,
5. Kjo nuk është mirë që për shkak të mungesës së kontenjerëve në periudhën që prej para prillit të vitit 2011, nuk ka pasur mbulesë adekuate të familjeve me kontenjerë, e cila ka cuar deri tek komunikimi i keq me një numër të qytetarëve.

Komuna e Kllokot-Vërbovcit në vitin 2010 nga buxheti i vet ka ndarë mjetet dhe një pjesë ka mbuluar shpenzimet për këtë shërbim i cili është dhënë komunës nga KRSHP „Higjiëna” nga Gjilani.

Shuma e realizuëshme e mjeteve operationale e KRSHP „Higjiëna” në vitin 2010 i ka fituar nga USAID nga programi DEMI dhe qytetarëve në këtë periudhë, por para kësaj nuk kan paguar asnjë shpenzim për këtë shërbim. Me arsyetim se me këtë lloj shërbimi nga qytetarët nuk është paguar rreziku i mundshëm mund të jetë përqindja e vogël e pagesës nga ana e qytetarëve.

Mbulesat

Komuna e Kllokot –Vërbovcit me 100 kontenjerë metalik (1,1 m³) të cilat i ka fituar nga USAID-i (programi EMII), janë shpërndarë në të katër fshatrat e komunës sic janë shënuar në tabelën e më poshtme. Me gjithë atë, ky nuk është numër i mjaftueshëm i kontenjerëve për shkak se më shumë se 7 familje e shfrytëzojnë një kontenjer.

Me një analizë të detajuar të gjendjes në teren është konstatuar se komuna Kllokot-Vërbovc ka nevojë edhe për 50 kontenjerë (1,1 m³). Komuna në prill të vitit 2011 ka marrë donacion nga USAID-i (programi DEMI) në formë metalike 50 kontenjerë me vëllim 1,1 m³.

KRSHP „Higjiena“ kontenjerat e ri do ti vendosë nëpër fshatrat e komunës së Klllokot-Vërbovcit ashtu sic është e paraparë në tabelën poshtë.

Numri i dhënë i kontenjerave 50 (gjithsej 50) është e mundur që një kontenjer tani shërben mesatarisht prej 5.32 familjeve që i përgjigjet standardeve.

Plani për shpërndarjen e kontenjerëve për komunën e Klllokot-Vërbovcit

Përditësuar	Zona katastrale	Numri i familjeve	Numri i subjekteve e afariste & institucioneve publike	Numri i rendori kontenjerëve	Numri i momentali kontenjerave	Numri i shtesë i kontenjerëve	Gjithsej	Nr. i familjeve me nga 1 kontenjer
20.04.2011								
1.	Klllokot	235	50	prej 1 deri 57	36	21	57	5
2.	Mogilla	210	9	prej 58 deri 99	30	11	41	5.1
3.	Vërbovc	139	12	Prej 100 deri 132	25	7	32	4.3
4.	Grncar	96	4	prej 132 deri 150	14	6	20	4.8

Orari i grumbullit të mbeturinave

KRSHP „Higjiëna” nga Gjilani dhe komuna e Kllokot-Vërbovcit janë pajtuar që të grumbullojnë mbeturinat e ngurta në territorin e komunës Kllokot-Vërbovcit të jenë në përputhje me orarin e mëposhtëm:

<i>Dita</i>	<i>Vendi</i>	<i>Koha</i>	<i>Sasia në ton</i>	<i>Ture kamiona çishtënja smeta</i>	<i>Gjithsej</i>
<i>E Hënë</i>	Kllokot	08:00-16:00	6.88 t	2	6880 kg
<i>E Marte</i>	Mogillë	08:00-16:00	5.9 t	2	5900 kg
<i>E Mërkure</i>	Vërbovc	08:00-16:00	4.59 t	2	4590 kg
<i>E Enjëte</i>	Grnar	08:00-16:00	2.35 t	1	2350 kg
<i>E Prente</i>	Kontenjeërt e stërm bushur në Kllokot	08:00-16:00	2.25 t	1	2250 kg
5	4	40	21,97 t	8	21970 kg.

Deponitë e egra


Deponitë e egra janë arsyeja kryesore për arsye sepse qytetarët e komunës së Kllokot-Vërbovcit edhe më tutje nuk janë të kënaqur me këto shërbime. Deponitë e egra të përhershme ndotin ambientin, sidomos burimet e ujit ku komuna është jashtëzakonisht e pasur, dhe kjo con në një ndikim negativ në shëndetin e përgjithshëm të banorëve të komunës së Kllokot- Vërbovcit. Grupi punues nga mesi i muajit prill të vitit 2011 ka vërtetuar që në territorin e komunës së Kllokot-Vërbovcit ekzistojnë **11 deponi të egra**. Lokacioni dhe përshkrimi i deponive të egra, si dhe specifikacioni i mjeteve të nevojhme për eliminimin e tyre janë bashkangjitur në Aneksin 1 në fund të këtij plan veprimi.

MENDIMI I QYTETARËVE TË KOMUNËS SË KLLOKOT-VËRBOVCIT PËR GRUMBULLIMIN DHE DEPONIMIN E MBETURINAVE

Kompanija për testimin e mendimit publik UBO Consulting ka filluar në vitin 2010 në të gjitha komunat ka bërë anket e cila ka pasur për qëllim të vërtetoj kënaqësinë e qytetarëve me shërbimet komunale. Në komunën e Kllokot-Vërbovcit në pyetjet e parashtruara mbi pastrimin dhe grumbullimin e mbeturinave qytetarët kanë dhënë përgjigjet si në vijim:


Sajeni të kënaqur me grumbullimin dhe deponimin e mbeturinave?

	Shumë të kënaqur	Deri diku të kënaqur	Deri diku të pakënaqur	Shumë të pakënaqur	Nuk e di/Refuzim
Kllokot	4.5%	29.5%	27.3%	20.5%	18.2%
Mesatarja e Kosovës	9.4%	28.1%	33.9%	22.0%	6.6%




A jeni të kënaqur me pastërtinë në komunën tuaj?

	Shumë të kënaqur	Deri diku të kënaqur	Deri diku të pakënaqur	Shumë të pakënaqur	Nuk e di/Refuzim
Klllokot	39.8%	37.5%	2.3%	2.3%	18.2%
Mesatarja e Kosovës	10.4%	49.0%	22.4%	14.1%	4.0%



Spjegimet (arsyvet)për çfarë komuna,është deri diku e pastër ose jo e pastër?

	Sjellje e dobët qytetare	Pluhuri nga punët ndërtimore	Shportat e mbeturinave janë largë	Nuk ka shporta të mbeturinave	Mbetjet e mbeturinave të punëve ndërtimore	Mbeturinat rreth kontenjerëve
Kllokot	0.00%	0.00%	50.00%	50.00%	0.00%	0.00%
Mesatarja e Kosovës	30.30%	9.50%	18.20%	20.90%	8.10%	13.00%



Rezultatet e anketës kjarhtë tregojnë që vetëm 4/5 % e qytetarëve ishin tejet të kënaqur me shërbimet e grumbullimit dhe deponimit të mbeturinave. Kjo ishte një tregues i qarte se situata është urgjente dhe kërkon qasje të menjëhershme për zgjidhjen e problemeve.

Për këtë është formuar grupi punues në kuadër të komunës e cila ekskluzivisht do të merret me këto probleme. Grupi punues ne mars të vitit 2011 së bashku me USAID-in programin DEMI kanë filluar me aktivitetet të cilat kanë për qëllim të kenë krijim të qëndrueshëm dhe program efikas për grumbullimin dhe deponimin e mbeturinave dhe sistem të mirë me pamje kualitative dhe ofrim të shërmive nga ana e qytetarëve. Në lidhje me këtë në mars të vitit 2011, në kordinim me përfaqsesit e fshatrave, është bërë anketa mbi ofrimin e shërbimeve. Rezultatet e anketës tregojnë që kontenjerët në shumicën e rasteve janë të stermbushur dhe së mbeturinat kudhet rreth kontenjerëve jo tregon se urgjentisht duhet të marrin 50 kontenjera shtesë (1100 l), çfarë edhe është bërë në prill të vitit 2011 nga ndihma e USAID –it programit DEMI.

Kjo ka ndikuar për të përmirësuar kënaqësinë e qytetarëve, por rezultatet e anketës në mes qytetarëve në mars të vitit 2011 tregojnë se qytetarët edhe më tej pjesërisht janë të kënaqur me shërbimet. Arsyja e moskënaqësisë gjithashtu mund të jenë deponitë e egra në të gjitha fshatrat e komunës së Kllokot-Vërbovcit dhe cmimi i lartë për pagesën e shërbimeve të grumbullimit dhe deponimit të mbeturinave.

Idetë dhe mënyra për përmirësimin e shërbimeve:

Komuna në periudhën e ardhshme është e obliguar për tërheqjen e vëmendjes në vazhdim:

1. Edukimin e qytetarëve në mbrojtjen e mjedisitjetësor, ndikimin e dëmshëm të mbeturinave në shëndetin e njeriut dhe rrethit të tyre, dhe rëndësinë e përdorimit të kontenjerëve në deponimin e mbeturinave (shtypjen e materialin promovues, emisione në radio lidhje me këtë temë, kyqjen e OJQ-ve, studentët dhe punëtorët shëndetësorë në promovimin e kampanjave, takime publike me përfaqsesit e fshatrave etj)
2. Përfshirjen aktive të qytetarëve shërbimin e grumbullimit dhe deponimit të mbeturinave dhe mënyrën e ofrimit të shërbimeve (shtypjen e materialin promovues, emisione në radio lidhje me këtë temë, kyqjen e OJQ-ve, studentët dhe punëtorët shëndetësorë në promovimin e kampanjave, takime publike me përfaqsesit e fshatrave etj)
3. Blerjen e kontenjerëve shtesë dhe të gjitha paisjet tjera të nevojshme, në mënyrë që të krijohen kushte më të mira për qytetarët që mbeturinat të futen në kontenjer (SHËNIM: Në vitin 2010, komuna ka marrë kamionin për grumbullimin e mbeturinave (3.t) dhe 100 kontenjerë (1100l) nga USAID-i programi EMI, por duke iu falemderuar ndihmës nga USAID-i programi DEMI në prill të vitit 2011 ka blerë 50 kontenjerë shtesë (1100l) në mënyrë të ofrimit sa më të mirë të shërbimit të qytetarëve)
4. Dhënien e mjeteve të buxhetit komunal me qëllim të pagimit të pjesës së mbetur të borgjit komunal për grumbullimin e mbeturinave.
5. Inkurajimin e qytetarëve, e posaqërisht puntorët e qeverisjes lokale dhe shfrytëzuesit e mjeteve buxhetore të paguajnë fakturat e tyre për mbeturina dhe për të mundësuar vazhdimin e ofrimit të shërbimeve.

6. Dhënjën e mjetëve nga buxheti i Komunës me qëllim të pastrimit të deponive të egra dhe zhvillimin e hapësirës ku ekzistojnë deponitë e egra. Ndërtimin e parqeve në vendet ku gjenden deponitë e egra për motivim të mëtejshëm të qytetarëve, për të ngritur cilësinë e jetës së tyre dhe ndikimin në vetëdijësinë e qytetarëve që mbeturinat të futen në kontejner.
7. Aktivizimin e inspektionit komunal, zgjerimin e inspektorit kompetent sanitar dhe punën e tyre të përditëshme në teren për të kontribuar në realizimin e qëllimit të këtij Plan Veprimi (shikoi qëllimet më poshtë) dhe vazhdimin për parandalimin e deponimit të mbeturinave në deponitë e egra në paralajmërimin dhe ndëshkrimin e qytetarëve të pandërgjegjshëm;
8. Bashkëpunimi ndërkomunal me komunat tjera në rastë të mungesës së inspektionit kompetend në Komunë në mënyrë të fillimit të ndihmës.
9. Miratimin e Rregullores për administrimin e mbeturinave dhe marrjen e masave ndëshkuese, për bërjen e një kornize ligjore për nevojat e shërbimit të inspektionit dhe respektimin e sanksioneve ndaj atyre që nuk e respektojnë ligjin.
10. Mbajne raport mbi menaxhimin e arritur në 6 muaj.

11. Aprovimin e Planit të veprimit për përmirësimin e shërbimeve në Kuvendin komunal

**** SHËNIMI: Detajet e planit të veprimit për përmirësimin e shërbimeve janë të bashkangjitura më poshtë**

VIZIONI I KOMUNËS SË KLOKOT-VËRBOVCIT

Ambient të pastër dhe të shëndoshë, shfrytëzimin e kushteve të favorshme klimatike, mbrojtjen e burimeve të ujit mineral natyral, token pjellore të bujqësisë, zhvillimin e më tejshëm të turizmit dhe zhvillimin e gjithanshëm ekonomik të komunës.

MISIONI I KOMUNËS SË KLOKOT-VËRBOVCIT

Program të qëndrueshëm dhe të suksesshëm për grumbullimin dhe deponimin e mbeturinave në tërë territorin e komunës, krijimin e një programi të ricklimatit, një ambient i pastër dhe i shëndoshë dhe ngritja e kualitetit të ambientit jetësorë për të gjithë qytetarët tanë është misioni ynë. Në këtë kuptim ne duam që të përmirësojmë vazhdimisht cilësinë e shërbimeve, modernizimin dhe të bëjmë atë në dispozicion për të gjithë qytetarët e komunës sonë. Dëshirojmë që ndërgjegjja e qytetarëve mbi menaxhimin e mbeturinave ta ngrisim në nivelin më të lartë dhe që të njejtët të përfshihen në mënyrë aktive në programin e cilësisë kualitative për grumbullimin dhe deponimin e mbeturinave.

Qëllimi i Planit të veprimit për përmirësimin e shërbimeve të grumbullimit dhe deponimit të mbeturinave

Qëllimi 1: Ofrimin e shërbimeve të grumbullimit dhe deponimit të mbeturinave në të gjitha zonat kadastrale të komunës në blerjen e pajisjeve të nevojshme për to, dhe për heqjen e të gjitha deponive të egra ekzistuese në komunën e Kllokot-Vërbovcit.

Qëllimi 2: Ngritja e nivelit të kënaqësisë së qytetarëve dhe përmirësimi i përgjithshëm i performancës së Komunës në pamjen e pastër të komunës dhe ofrimin e shërbimeve për grumbullimin dhe deponimin e mbeturinave.

Qëllimi 3: Ngritjen e vetëdijësimit të qytetarëve në mbrojtjen e nevojshme të ambientit dhe ngritjen e përgjegjësisë së qytetarëve në pamjen e ambientit të pastër.

TABELA 1: NIVELLI I DËSHIRUAR PËR PËRMIRËSIMIN E SHËRBIMEVE, REZULTATET DHE TREGUESIT

Rezultatet e dëshiruara	#	Treguesit e rezultateve të parapara	Baza për 2010	Qëlli mi për 2011	Qëllimi për 2012	Qëlli mi për 2013	Burimi i informacionit
I. Përmirësimi i cilësisë së shërbimit të grumbullimit dhe deponimit të mbeturinave	1	% sistemi i balancimit të grumbulluar, në përputhje me programin e përcaktuar më parë	25%	77,2%	80%	85%	Anketa
		Numri i ankesave të parashtruara në 100 përdruer	---	0%	0%	0%	Kompanija
II. Ngrija e nivelit të kënaqësisë së qytetarëve në ofrimin e shërbimeve të grumbullimit dhe deponimit të mbeturinave	2	% qytetarët të cilin janë të kënaqur ose shumë të kënaqur me grumbullimin e mbeturinave	4,5%	45%	65%	80%	Anketa
		% familjet të cilat kanë qasje në shërbimin e grumbullimit të mbeturinave	50%	100%	100%	100%	Kompanija
III. mbulimi i shërbimeve të grumbullimit dhe deponimit të mbeturinave në tërë territorin e komunës	2	% vendbanimet në të cilat ofrohen shërbimet e grumbullimit të mbeturinave	50%	100%	100%	100%	Kompanija
		% familjet të cilat e paguajnë shërbimin	0%	25%	50%	60%	Kompanija
IV. stabiliteti dhe qëndrueshmëria e shërbimit të grumbullimit dhe deponimit të mbeturinave të ngurta	1	% mbulimi i shpenzimeve nga parapagesit e fakturave për shërbimt e ngumbullimit te mbeturinave					Kompanija
		2					

TABELA 2: TREGUESIT E TIERË PËR SHËRBIMIN E GRUMBULLIMIT DHE DEPONIMIT TË MBETURINAVE

Definicioni	Baza për 2011	Qëllimi për 2012	Qëllimi për 2013	Burimet e informacioneve
TË DHEËNAT(Investimet):				
Buxheti i Komunës në €(Vlera prej 18000€ është në linjen buxhetore për vitin 2012,mjetet të cilat do të hargjohet për të gjitha shërbimet komunale)	0	18000	25000	Drejtoria për Ekonomi dhe Financa
Vlerën e marrëveshjes së nënshkruar me Higjiënën në nivelin vjetor	25600	/	/	Drejtoria për shërbime publike dhe KRSHP-së
Hargjimet për shërbimin e grumbullimit dhe deponimit të mbeturinave në nivelin vjetor				Drejtoria për shërbime publike dhe Higjiëna
Numri i kontenjerëve metalik me kapacitet 1,1m ³	150	10	5	Drejtoria për shërbime publike
Nurmi i kontenjerëve plastik familjar me kapacitet 110 L	0	30	0	Drejtoria për shërbime publike
Broj kamiona za sakupljanje i odlaganje otpada	1	2	0	Drejtoria për shërbime publike
Disa përgaditje tjera:traktorë,mini kamion ose mekanizëm për terenet e papërshatshme	0	1	0	Drejtoria për shërbime publike
Numri i të punësuarve	5	6	7	Drejtoria për shërbime publike
Definicioni	Baza për 2011	Qëllimi për 2012	Qëllimi për 2013	Burimet e informacioneve
PRODHIMI:PIJESËMARRJA				
Grumbullimi i mbeturinave në ton në nivelin vjetor	700t	1000t	1250t	Drejtoria për shërbime publike-Shërbimet komunale--koordinator
Numri i familjeve të cilët marrin shërbime	680	735	750	

Numri i familjeve të cilët nuk marrin shërbime	0	55	70	
Numri i përgjithshëm i familjeve	680	735	750	
Numri i subjekteve afaristë të cilët marrin shërbime	65	85	100	
Numri i institucioneve lokale të cilët marrin shërbime	10	15	20	
% e pagesave të fakturave për shërbimet e grumbullimit të mbeturinave sipas familjeve	25	45	60	
% e pagesave të fakturave për shërbimet e grumbullimit të mbeturinave sipas subjekteve afariste	25	55	70	
% e pagesave të fakturës së shërbimeve të grumbullimit të mbeturinave sipas institucioneve	50	100	100	
SUKSESET:				
Hargjimet në ton të grumbullimit të mbeturinave	6.10	6.10	6.10	Drejtoria për shërbime publike-Shërbimet komunale-koordinator

TABELA 3:INFORMATAT E BUXHETT PËR GUMBULOIMIN DHE DEPONIMIN E MBETURINAVE

Burimet	2011	2012	2013	Burimet e Informacionit
PLANIFIKIMI I TË HYRAVE NGA PAGESAT E FAKTURAVE				
Numri i familjeve 680 x4,75 euro faktura për mbeturina = 3,230 x12 mujore – 38,760.00 euro	38,760.00	41,895.00	42750	Zyrtari për shërbime publike
Numri i subjekteve afariste 65x10.5 euro për mbeturina=682.50x12 muj=8,190.00euro	8,190.00	8,190.00	8,190.00	Zyrtari për shërbime publike
Institucionet publike(shkollat,shhtëpitë e shëndetit/ambulantat,Shtëpia e kulturës,stacioni policor,shërbimet e zjarrfikësve dhe Dr..10x21=210x12muj=2,520 euro	2,520.00	2,700.00	2,700.00	
KAPITALNA ULAGANJA				
Blerja e kontenjerëve të rinjë 15x266=3,990.00euro	0	2,660.00	1,330.00	Zyrtari për shërbime publike
Blerja e kontenjerëve plastic për familje nr 30x35 euro për kontenjer=1,050.00euro	0	1,050.00	0	
Rregullorja e deponive(ndertimi I paqeve ne lokacione:a)Vërbovc rruga përmes Gjytkarit,ne vendin ku gjindet deponia e egër;b)Klioko dhe c) Grncar	14,500.00	15,000.00	40,000.00	zyrtari për zhvillim ekonomik

					dhe projekte
Numri i kamionëve për grumbullim dhe deponim të mbeturinave	1	2	0		
Përgaditje tjera: traktor për terene të papërshtatshme	0	25.000	0		
Tjera	0	0	0		
HARGJIMET E NEVOJSHME					
Dita e pastrimit të komunës-aksioni vjetor I pastrimit të qytetit nga ana e qytetarëve dhe stafit komunal(në euro)	2.000	2.000	2.000		
Përgaditja e materialit promovues për informim të qytetarëve	300.00	400.00	400.00		zyrtar për shërb.kom
Pregaditja e pyetësorit,zbatimi I anketës,përpunimi dhe publikimi I rezultateve	0	200.00	200.00		OJQ
GJITHSEJT:	2,300.00	2,600.00	2,600.00		

PLANI AKSIONAR PËR PËRMIRËSIMIN E SHËRBIMEVE

Qëllimet për rezultatet e propozuara në vitin 2012 -2013

1.Komuna e Kll-Vr ka për qëllim që ti përmirësoj shërbimet në mbledhjen e mbeturinave dhe e njëjta të zgjerohet në numër më të madh të ekonomive familjare nga 50 në vitin 2010 në plotëni të plotë në mbulimin e shërbimeve të ofruara të gjitha ekonomive familjare në 100 në vitin 2012 -2013.

2. Komuna e Kll-Vr ka për qëllim të përmirësoj nivelin e kënaqshëm të qytetarëve me shërbime. Në vitin 2010 gjithsej 4.5 % e qytetarëve kanë qenë shumë të kënaqur me shërbimet e grumbullimit dhe deponimit të mbeturinave. Qëllimi ynë është që në vitin 2011 qytetarët të jenë shumë të kënaqur me shërbimet, në vitin 2012 65, ndërsa në vitin 2013 dëshirojmë që 80 % e qytetarëve të jenë shumë të kënaqur me shërbimin e grumbullimit dhe deponimit të mbeturinave

3. Komuna e Kll-Vr ka për qëllim të ngris vetëdijen e qytetarëve dhe të ju sqaroi arsyen e pagesës së fakturave për shërbimet e grumbullimit dhe deponimit të mbeturinave. Supozohet se deri në fund të vitit 2012 përqindja e mbledhjes së të ardhurave për familje kap shumën 25 %, Qëllimi ynë është që në vitin 2012 45 %, ndërsa në vitin 2013 të jetë 60% familjet paguajnë shërbimet e grumbullimit dhe deponimit të mbeturinave. Me këtë ne do të sigurojmë qëndrueshmëri dhe përmirësim të vazhdueshëm të ofrimit të shërbimit të grumbullimit dhe deponimit të mbeturinave.

Qëllimet për produkteve të propozuara/efektet në vitin 2012-2013

Qëllimet për propozimet efektive dhe produktet e shënuara në tabelën 2 do të arrihet me ndihmën:

1. të dhënat e mjeteve buxhetore në kohë për përmirësimin e shërbimeve;
2. blerjen e përgaditjeve të nevojshme;
3. arrijtjet e kompanisë kompetente e cila ofron shërbime nga ana e qytetarëve dhe Komunës;
4. investimet ne asfaltimin e rrugëve të hapura që shërbimi të jetë i kyqur për cdo familje;
5. numri i familjeve të cilëve shërbimi do tu jetë i kyqur me 680, në vitin 2011 do të jetë i ngritur në 735 familje, në vitin 2012 750 familje dhe në vitin 2013, e kjo tregon se 100% e familjeve tdo të marrin shërbime të grumbullimit dhe deponimit të mbeturinave. Prandaj kemi paraparë që sasia e mbledhjes së mbeturinave për vit të jetë prej 700t në vitin 2011, në vitin 2012 të jetë 1000t dhe 1250t ë vitin 2013. Me këtë dëshirojmë që cdo mbeturinë nga familjet dhe subjekte afariste të jetë e grumbulluar në mënyrë adekuate dhe si duhet të hudhet në deponi.

PLANI PËR REALIZIMIN E REKOMANDIMEVE NGA PLANI I VEPRIMIT PËR PËRMIRËSIMIN E SHËRBIMEVE TË GRUMBULLIMIT DHE DEPONIMIT TË MBETURINAVE

<p>Qëllimi1:Zgjerimi i shërbimeve në të gjitha zonat kadastrale dhe familjeve do të arihet me blerjen e mëshumë përgaditjeve(kontenjer dhe dr.)</p> <p>Qëllimi2: Realizimi i këtij plan veprimi do të ngris kënaqësinë e qytetarëve,kualltetin e jetës së tyre,e vec kesaj edhe efektet e Komunës kur është në pyetje arritja e ofrimit të shërbimeve të grumbullimit dhe deponimit të mbeturinave.</p> <p>Qëllimi3: Realizimi i këtij plani për vetëdijësimin e qytetarëve dhe mbrojtjen e ambientit jetësor dhe përgjegjësisë së tyre në këtë drejtim do të jetë ingritur në nivel më të lartë,i cili është qelësi i arritjes përfundimtare e ajo është që komuna e Kllokot-Vërbovcit të jetë e pastër dhe e shëndetshme.</p>			
<p>Rezultatet e dëshiruara:</p> <ul style="list-style-type: none"> - Përmirësim kualitativ i shërbimit të grumbullimit të mbeturinave - Ngritja e nivelit të kënaqësisë së qytetarëve me shërbimet - Gjithë territori i komunës të jetë i mbuluar shërbimin e grumbullimit dhe deponimit të mbeturinave - Ofrimi i shërbimit të jetë i sigurtë dhe i qëndrueshëm 			
<p>Aktivitetet / Hapat / Projekti</p>	<p>Hapat dhe përgjegjësitë e përbashkëta</p>	<p>Afati kohor dhe vlera e projektit (€)</p>	
<p>1. Aprovimi i Planit të veprimit për përmirësimin e grumbullimit dhe deponimit të mbeturinave nga ana e kryetarit dhe/ose Kuvendit komunal</p>	<p>a. Përgaditja dhe dorëimi i projektit përfundimtar SIAP nga ana grupit punues të komunës e cila ka punuar SIAP(Plani i veprimit për përmirësim të shërbimeve)</p> <p>b. Miratimi nga ana e Kryetarit</p> <p>c. Përfaqësimi dhe miratimi nga ana e kryetarit,kryesuesi i Kuvendit dhe grupit punues SIAP</p>	<p>a – c fillimi shtator2011</p> <p>Vlera = 0</p>	
<p>2. Marrveshja me kompaninë e cila ofron shërbim</p>	<p>a. Rishikimi i marrëveshjes me AkrsHP „Higjiena“(pjesa rreth pagesës së puntoreve,kompenzimi i Komunës nga ana e Higjienës për pagesën e 5 punëtorve)</p> <p>b. Në rast nevojë nënshkrimi i marrëveshjes së re-Kryetari</p>	<p>Tetor 2011</p> <p>Pa kosto</p>	
<p>3. Largimin e deponive të ergra dhe ndërtimi i parkut në Vërbovc</p>	<p>a. Përgaditja e planit për largimin e deponive të ergra (11)-SIAP grupi punues,kompanija Higjiena dhe kompanija për ndërtimin e projektit(gjialbrimin/e parqeve të qytetit)</p> <p>b. Realizimi i projektit(largimi i deponive të ergra dhe ndërtimi i parkut)</p>	<p>SHTATOR – TETOR (7) 2011</p> <p>Vlera e projektit:</p> <p>26,069.30 €</p>	

4. Ndërtimi i lojërave për fëmijë ose parku në vendin e deponive të egra në lokacionin _____	c.	a – b: 2012.vit Vlera a: 5,040.00 € b:1400 € c: 25,000.00 €
5. Mbledhja dhe shpërndarja e kontenjerëve të rinj 1m ³ ose kontenjerëve familjar 120L ose paisjeve tjera(traktor ose mini kamion)	a. Shpallja e tenderit dhe blerja e kontenjerëve(15 kontenjer metalik nga 1m ³ dhe 30 kontenjer plastik individual prej 120L)-KRSHP Kompanija b. Bëria e planit të shpërndarjes së kontenjerëve-Kompanija KRSHP c. Kompanija Blerja e traktorëve ose mini kamion –Kompanija KRSHP	a – b: 2012.vit Vlera a: 5,040.00 € b:1400 € c: 25,000.00 €
6. Plani për ofrimin e shërbimeve atyre familjeve të cilët nuk marrin shërbime ose ofrim të shërbimeve atyre familjeve që nuk janë të kënaqur me shërbimet	a. Përpunimi i planit Hartimi dhe ekzekutimi i planit për mbulimin me shërbim të vendbanimeve të reja në vitin 2012 – DSHP, Kompania Higjiëna b. Përpunimi dhe realizimi i planit të ofrimit të shërbimit qytetarëve të cilët nuk janë të kënaqur me shërbimet-Kompanija KRSHP	a: gjysma e parë 2012 b: gjysma e parë 2012 Vlera =0
7. Identifikimi dhe regjistrimi i përdoruesve të rinjë:subjeketet afariste,institucionet,familjet dhe pagues të tjerë të mundshëm shfrytëzues të shërbimeve	a. Identifikimi dhe regjistrimi i shfrytëzuesve të rinjë: subjeketet afariste,institucionet,familjet dhe pagues të tjerë të mundshëm shfrytëzues të shërbimeve-KRSHP b. Evidentimi dhe ofrimi i fakturave shfrytëzuesve të rinjë të shërbimeve-KRSHP	a: dhjetor 2011 – <u>janar 2012 ?</u> Vlera: 8 000 €
8. Veprimi që synon ngritjen e vetëdijes së qytetarëve në pikëpamjen e shërbimeve(marketingje,kampanjat promovuese,materiali promovues dhe tjera)	a. Hartimi i planit dhe përcaktimi i mjeteve të cilat do të shfrytëzohen për kampanjë publike b. Përgaditja dhe shpërndarja e materialit promovues c. Përgaditja e pyetësorëve,bëria e anketave,përpunimi dhe shpallja e rezultateve	a: nëntor 2011 b: përsëri 2011 i 2013 c: shtator 2012, shtator 2013 Vlera e projektit: 3000 €
9. Mirëmbajtja e parqeve të ndërtuara	a. Dhënia e mjeteve për mirëmbajtjen e parqeve dhe mbledhja e mbeturinave në lokacionin e parkut në Vërbovë-Komuna	Tetor 2011 Vlera: 100€
10. Riciklimi	a. Identifikimi i kompanisë për riciklim b. Marrëveshja me kompaninë për riciklim-Komuna c. Shpërndarja e kutive për selektimin e mbeturinave për riciklim në territorin e komunës-kompanija për riciklim	a. tetor 2011 b. janar 2012 c. mars 2012

Strategjia për mbledhjen e të dhënave dhe komunimi me qytetarët

Strategjia për mbledhjen e të dhënave

Mjetet e informimit/burimet	Hapat e mbledhjes së të dhënave dhe informatat	Përgjegjësitë	Afati kohor
Përgaditja dhe shpërndarja e broshurave informative dhe posterave për efektet e dëmshme të deponive të ëgra në shëndetin e njeriut dhe mjedisit	a. Projektimi publik(promocionet)kampanjat	SIAP Grupi punues në bashkëpunim me DEMI-n	Shtator -tetor 2011
	b. Përgaditja dhe shpërndarja e broshurave,posterave informativ të cilt kanë për qëllim ti informojnë qytetarët në efektet e dëmshme të deponive të ëgra në shëndetin e njeriut dhe mjedisit	KRSHP,Zyra për informim,SIAPP grupi punues në bashkëpunim me DEMI-n	Nga njëherë në gjysmën e dytë të vitit 2011, 2012 i 2013
Hulumtimi i opinionit publik	a. Planifikimi dhe bëria e anketës b. Përpunimi i të dhënave nga anketa dhe shpallja e rezultateve	SIAP grupi punues, DEMI	shtator2012, tetor 2013

Plani i komunikimit me qytetarët

Komuna e Klllokot-Vërbovcit ka për qëllim që qytetarët në mënyrë aktive ti kyq në procesin gjithëpërfshirës i cili do të qojë në përfundimin e qëllimit të kënaqshëm, e ajo është ambienti i shëndoshë dhe i pastër dhe programi i qëndrueshëm i grumbullimit dhe deponimit të mbeturinave. Atë do ta arrijmë në menyra të ndryshme:

1. Qytetarët do të jenë të kyqyr në mënyrë aktive në vlerësimin e ofrimit të shërbimeve të grumbullimit dhe deponimit të mbeturinave. Formulari i thjeshtë reth asaj se a janë qytetarët të kënaqur me shërbimet do të jetë i plotësuar nga ana e qytetarëve dhe në atë rast kompanija vazhdimisht so të përmirësoj shërbimet në përputhje me kërkesat e qytetarëve. Hulumtimi i opinionit publik do të organizohet me anketat në rrugë gjatë tremujorit të fundit të vitin 2012 dhe 2013. Grupi punues e cila ka punuar në bërjen e këtij plan veprimi (SIAP) do të shfrytëzoj rezultatet e anketave që eventuaisht të rinovoj këtë dokument, me qëllim për të arritur synimet e tyre.
2. Ngritja e vetëdijës për një qytet më të pastër përmes broshurave informative, fletushkave posterave të cilët tek qytetarët do të kenë ndikim që mbeturinat e tyre ti asgjësojnë sipas kësaj rregullore dhe të paguajnë për shërbimet.

PLANI I MONITORIMIT DHE RAPORTIMIT

1. Grupi punues (SIAP) do të mbajë takime mujore duke filluar nga shatori i vitit 2011 për të diskutuar arritjet e qëllimeve dhe aktiviteve të parapara në këtë plan. Grupi punues sipas nevojës do të marrë të gjitha aktivitetet e tjera të nevojshme për realizimin e qëllimeve të aktiviteve.
2. Grupi punues në procesin e realizimit të këtij plani në cdo tre muajt do të raportoj kryetarin, kryesuesin e Kuvendit dhe drejtorin e shërbimeve publike.

Raporti mbi treguesit, objektivat dhe realizimin e qëllimeve

#	Rezultatet e treguara të kënaqshme	Baza për 2010	Qëllimi për 2011	Bilanci 2011 (31. decembar)	Përmirësimi	Qëllimi 2012
1	% sistemi I grumbullimit të balancuar, në përputhje me programin që ishte përcaktuar më parë	25%	77,2%			80%
2	Numri I ankesave të bashkangjitura në 100 shfrytëzues	---	0%			0%
3	% qytetarët të cilën janë të kënaqur ose shumë të kënaqur me grumbullimin e mbeturinave	4,5%	45%			65%
4	% familjet të cilët janë të kënaqur me grumbullimin e mbeturinave	50%	100%			100%
5	% venbanimet në të cilat ofrohet shërbimi I grumbullimit të mbeturinave	50%	100%			100%
6	% familjet të cilat paguajnë shërbimet	0%	25%			50%
7	% mbulimi I hargjimeve nga parapaguesit e fakturave për shërbimet e mbeturinave	8%	25%			60 %

ANEKSI 1:DEPONITË E EGRA NË KOMUNËN E KLLOKOT-VËRBOVCIT

Pamja ekzistuese e deponive prill 2011:



Kllokot - 1



Vërbovc -1



Grncar -1



Vërbovc -2



Mogillë-1



Mogillë -2

Gjendja e analizuar në teren, anëtarëve të grupit punues konstatojnë se ndër të tjera në komunë ekzistojnë 11 deponi të egra të cilat kanë ndikim shkatërrues në mjedisin jetësor dhe në shëndetin e qytetarëve të komunës së Kllokot-Vërbovcit. Me këtë grupi punues komunal, si dhe pjesa integrale e planit të veprimit për përmirësimin e shërbimeve të grumbullimit dhe deponimit të mbeturinave, kanë bërë planin detal për largimin e deponive të ergra i cili është bashkangjitur në tabelën nr 1 më poshtë:

Tabela 1: Lokacioni, madhësia dhe mekanizmat e nevojshëm për largimin e deponive të ergra

Numri dhe emri i vendit në të cilën gjinden gropimet(1)	Madhësia e vlerësuar Size (2)	Mbeturinat e vlerësuara(3)	Materijali i vecantë i nevojshëm për pastrim(4)	Hargjimet e vlerësuara për pastrim(5)	Planifikimi i datave për pastrim	Numri i shenjave(6)
1- Në teritorin e fshatit Kllokot ekzistojnë tri deponi të egra dhe atë në këto lokacione:						
(K-1) në hyrje në fshatin nga drejtimi i Vitisë	(1) Përafërsisht 350-450 m ²	(1) 20-25 m ³	(1) Skip, Ngarkues, Kamion 25ipper		(1)	(1) Nevojiten 2 shenja që tregojnë deponi të egra
(K-2) rreth lumit Morava e Bincës	(2) Përafërsisht 100 m ² - 180m ²	(2) rreth 15 m ³ pjesërisht deponi të djegura	(2) Skip, Ngarkues, Kamion 25ipper		(2)	(2) Nevojiten 3 shenja që tregojnë deponi të egra
(K-3) vendi i quajtur Sipavica	(3) Përafërsisht 500m ² - 800m ²	(3) rreth 30m ³ - 40m ³	(3) Skip, Ngarkues, Kamion 25ipper		(3)	(3) Nevojiten 3 shenja që tregojnë deponi të egra.
2- Në teritorin e fshatit Vërbovc ekzistojnë tri deponi të egra dhe atë në këto lokacione:						
(V-1) Tek varrezat ortodokse	(4) Përafërsisht 800-1000 m ²	(4) 50-70 m ³	(4) Skip, Ngarkues, Kamion 25ipper		(1)	(4) Nevojiten 3 shenja që tregojnë deponi të egra.

(V-2) në afërsi të shkollës fillore afër lumit në Gërncar	(5) Përafërsisht 300 m ² - 400m ²	(5) rreth 50 m ³	(5)Skip,Ngarkues, Kamion 26ipper		(2)	(5) Nevojiten 2 shenja që tregojnë deponi të egra.
(V-3) kod velikog mosta put prema Đelekare te ura e madhe rruga për Gjylekar	(6) Përafërsisht 500m ² - 800m ²	(6) rreth 30m ³ - 40m ³	(6)Skip,Ngarkues, Kamion 26ipper		(3)	(6) Nevojiten 4 shenja që tregojnë deponi të egra
3- Në teritorin e fshatit Mogillë ekzistojnë tri deponi të egra dhe atë ne kto lokacione:						
(M-1)në hyrje të fshatit Mogillë	(7) Pjesërisht në pastrimin e rregullimit të rrugëve400 m ²	(7) rreth 20 m ³	(7)Skip,Ngarkues, Kamion 26ipper		(1)	(7) Nevojiten 2 shenja që tregojnë deponi të egra.
(M-2) Tek varrezat ortodokse serbe	(8) Përafërsisht 600 m ² - 800m ²	(8) rreth 30 m ³	(8)Skip,Ngarkues, Kamion 26ipper		(2)	(8) Nevojiten 2 shenja që tregojnë deponi të egra.
(M-3) tek varrezat e shqiptarëve	(9) Përafërsisht 100m ²	(9) rreth 15 m ³	(9)Skip,Ngarkues, Kamion 26ipper		(3)	(9) Nevojiten 2 shenja që tregojnë deponi të egra.
4- Në teritorin e fshatit Gërncar ekzistojnë tri deponi të egra dhe atë ne kto lokacione:						
(G-1) vendi i quajtur Jezero i	(10) Përafërsisht 450 m ²	(10) rreth 25 m ³	(10)Skip,Ngarkues, Kamion 26ipper		(1)	(10) Nevojiten 2 shenja që tregojnë deponi të egra.

(G-2) përreth koritës së lumit Gërncarica përreth Kishës Sv.Nikolla	(11) Përafërsisht 600 m ² - 1000m ²	(11) rreth 50 m ³	(11) Skip, Ngar kues, Kamion 27ipper		(2)	(11) Nevojiten 2 shenja që tregojnë deponi të egra.
---	---	------------------------------	--------------------------------------	--	-----	---

Tabela 2: Secifikacioni për largimin e deponive të egra

Radhitja.nr:	Emri i aktiviteteve	Jed.mere	Sasia	Cmini në €	Gjithsej në €
1.	Grupi punues	Orari i punës	400	1.58 €	632.00 €
2.	Udhëtimi -Linja	Orari i punës	160	2.03 €	324.80 €
3.	Skiperi	Orari i punës	30	50.00 €	1500.00 €
4.	Kamioni	Linja	100	30.00 €	3000.00 €
5.	Shkuarja në deponi	Tona	500	6.10 €	3050.00 €
6.	Grupi punues	Orari i punës	1200	2.00 €	2400.00 €
7.	Dreka	Kom.	150	1.75 €	262.50 €
8.	Karakteristikat /do të thotë	Kom.	10	40.00 €	400.00 €
	Ukupan iznos				11.569.30 €

Tabela 3: Rregullimi i parkut

Pwrpunimi i projektit është në përfundim e sipër